

**Znj. Juliana Latifi** është zgjedhur Kryetare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, me Vendimin nr.96, datë 22.12.2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Znj. Latifi është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike - Juridike, dega Drejtësi, Universiteti i Tiranës (1991). Ajo mban gradën shkencore “Dr.” në shkencat juridike, në fushën e së drejtës private të krahasuar (1997). Në periudhën 2000 - 2002, ajo ka realizuar studimet post-doktorale në Universitetin Robert Schuman, Strarsbourg, dhe që nga viti 2015, ajo mban titullin shkencor "Prof.Dr."

Background-i i saj përfshin një karrierë të pasur profesionale dhe akademike.

Në periudhën 1992-1994, Znj. Latifi ka punuar si gjyqtare pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më pas, pranë Gjykatës së Apelit.

Në periudhën 1995-2002, Znj. Latifi ka punuar pedagoge e brendshme në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe titullare e lëndëve: E drejta civile; Pronësi, Trashëgimi dhe E drejta private e krahasuar, ku ka mbajtur edhe funksionin e Shefes së Departamentit të së Drejtës Civile (2000-2002). Në periudhën 2012-2015, ajo ka ushtruar funksionin e Dekanes në Fakultetin e së Drejtës së Biznesit, Tirana Business University, ku sot ajo vazhdon të jetë pjesë e stafit akademik dhe titullare në lëndët : E drejta civile, E drejta e shoqërive tregtare dhe E drejta e konkurrencës.

Znj. Latifi ka një eksperiencë të pasur si eksperte ligjore në fushën e draftimit të akteve ligjore dhe nënligjore, ku ajo ka punuar si këshilltare ligjore në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë gjatë periudhave 2003-2005 dhe 2013-2016. Ajo ka drejtuar grupe të ndryshme të punës në reformat e rëndësishme legjislative të realizuara në Shqipëri, në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së.

Në karrierën e saj profesionale, Znj. Latifi është angazhuar si eksperte ligjore pranë organizmave ndërkombëtarë në Shqipëri dhe jashtë saj, në përgatitjen e studimeve, dhënien e rekomandimeve dhe opinioneve, si dhe draftimin e akteve ligjore dhe nënligjore. Në periudhën 2005-2008, ajo ka punuar si eksperte e lartë ligjore në misionin e Kombeve të Bashkuara, Kosovë (UNMIK).

Background-i i saj përfshin edhe një kontribut të pasur në fushën e jurisprudencës shqiptare me publikimin e librave universitarë në fushën e së drejtës civile, të cilat janë pjesë e syllabusit zyrtar në Fakultetet e Drejtësisë në Shqipëri, Kosovë, në Shkollën e Magjistraturës, si dhe publikimin e artikujve të ndryshëm shkencorë jashtë vendit.